



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR' S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Zyra për Informim - Raporti vjetori i punës janar – dhjetor 2025

Zyra për Informim përbën një segment të rëndësishëm brenda qeverisjes komunale, që përmes informacioneve ditore, raporteve, njoftimeve e publikimeve të tjera, realizon transparencën e pushtetit kundrejt publikut, i cili ka të drejtë të plotë të njihet me punën e të zgjedhurve të vetë.

Gjatë vitit 2025, Zyra ka përgatitur dhe publikuar në ueb faqen e Komunës dhe profilin e saj në facebook si dhe ka shpërndarë për media 528 informacione ditore, ose mesatarisht nga dy e më tepër informacione në ditë pune, duke bërë kështu të mundur që puna e institucioneve vendimmarrëse dhe ekzekutive të jenë sa më transparente.

Pos informacioneve ditore, në web-faqe janë publikuar edhe 689 materiale të tjera, si vendime të kryetarit, vendime të Kuvendit Komunal, rregullore, raporte, procesverbale, paralajmërime të seancave të Kuvendit, konkurse, thirrje publike, si dhe aktiviteteve të tjera të ndryshme.

Si zakonisht, Zyra për Informim është kujdesur në mënyrë specifike edhe për azhurnimin e rregullt të ueb-faqes komunale.

Po ashtu, gjatë vitit 2025, Zyra, në koordinim me Kabinetin e Kryetarit, ka ftuar gazetarët në konferencat e kryetarit të Komunës, si dhe ka mbajtur kontakte të rregullta me mediat lokale e qendrore, në funksion të bashkëpunimit dhe transparencës.

Gjilan, 31.12.2025

Zyra për Informim